



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPSTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Çelënyje za Opštu Upravu

KOMUNA E RAHOVECIT

Nr. i prot. 3945
Br. prot. 17-08
Më 17-08 2021
Ra. Ut. 21
RAHOVEC - ORAHOVAC

OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC

KONTRATË

Numri i kontratës:¹ 623-21-4817-5-3-6/C295

Emri i Autoritetit Kontraktues: KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË, në njërën anë; dhe

Emri i Kontraktuesit: Grup i Operatorëve Ekonomik: "waterline" SH.P.K.; N.N.T. "Etniku", Rr.Brigada 123, Suhareke, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

Titulli i Kontratës: PUNIMI I HYRJES PËR ZHVESHTORE NË STADIUM

Me numër identifikues: 623-21-4817-5-3-6

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: Punimi i hyrjes për zhveshtore në stadium, sipas specifikimeve teknike të detyrueshme dhe pjesës së ofertës financiare që janë pjesë e kësaj kontrate.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me: datën e nënshkrimit dhe përfundon për një periudhë prej 10 ditë.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se [10] ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i ekzekutimit të punëve do të jetë: Në Komunën e Rahovecit.

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP² (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

² DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incotems 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **4,904.50 Euro**;

[Katërmijë e nëntëqindkatër Euro e pesëdhjetë Cent]

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të punëve.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të kryej ndonjë ose të gjitha punët brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së punëve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumë që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [Gjykata Themelore Prishtinë] në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen [Shqip]³ në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

| Për Autoritetin Kontraktues: | | Për Kontraktuesin: | |
|------------------------------|---|--------------------|---|
| Emri: | Astrit Mullabazi | Emri: | Kushtrim Kryeziu |
| Pozita: | Menaxher i Prokurimit | Pozita: | Drejtor |
| Nënshkrimi: |  | Nënshkrimi: |  |
| Data: | 17.08.2021 | Data: | 17.08.2021 |
| Vula: |  | Vula: |  |

³ Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

**PARAMASA DHE PARALLOGARIA PËR NDËRTIMIN E HYRJES PËR
ZHVESHTORE NE STADIUM**

| I PUNIMI I HYRJES PËR ZHVESHTORE NE STADIUM | | | | | |
|--|--|----------------|--------------|--------------|--------------|
| Nr. | Pozicioni | Njësia | Sasia | Çmimi | Shuma |
| 1 | Thyerja dhe demolimi me kujdes i betonit të armuar në pjesën e mbulcës me trashësi t=15cm, ngarkimi dhe transporti në deponi në largësi deri në 5km. | m ² | 14 | 20.0 € | 280.00 € |
| 2 | Thyerja dhe demolimi me kujdes i murit të tribunave prej betonit të armuar me trashësi t=10cm, ngarkimi dhe transporti në deponi në largësi deri në 5km. | m ² | 3.1 | 20.0 € | 62.00 € |
| 3 | Thyerja dhe demolimi me kujdes i murit të tribunave prej betonit të armuar me trashësi t=20cm, ngarkimi dhe transporti në deponi në largësi deri në 5km. | m ² | 3 | 20.0 € | 60.00 € |
| 4 | Thyerja dhe demolimi me kujdes i murit të tribunave prej bllokave të betonit me trashësi t=20cm, ngarkimi dhe transporti në deponi në largësi deri në 5km. | m ² | 12.5 | 5.0 € | 62.50 € |
| 5 | Gërmimi i dheut së bashku me mbeturina, ngarkimi dhe transporti në deponi në largësi deri në 5km. | m ³ | 4 | 4.0 € | 16.00 € |
| 6 | Furnizimi, transporti, mbushja dhe ngjeshja në shtresa e zhavorit me fraksion (0-32mm) në pjesën e kanalit ekzistues. | m ³ | 6 | 7.0 € | 42.00 € |
| 7 | Furnizimi, transporti dhe betonimi i themeleve me beton të klasës C30/37 me trashësi t=50cm, në çmim të llogaritet edhe furnizimi, transporti, prerja, lakimi dhe montimi i armaturës së themelit. | m ³ | 2.5 | 90.0 € | 225.00 € |

| | | | | | |
|----|--|----------------|-----|--------|----------|
| 8 | Furnizimi, transporti dhe betonimi i mureve anësore me beton të klasës C30/37 dhe me trashësi t=20cm , në çmim të llogaritet edhe furnizimi, transporti, prerja , lakimi dhe montimi i armaturës së murit. | m ³ | 2.8 | 90.0 € | 252.00 € |
| 9 | Furnizimi, transporti dhe muratimi i mureve me blloka prej betoni me dim.40x20x20cm. Muratimi i mureve të bëhet me llaq prej betoni. | m ² | 25 | 18.0 € | 450.00 € |
| 10 | Furnizimi, transporti dhe betonimi i serkllazheve me dim 20x25cm me beton të klasës C30/37 , në çmim të llogaritet edhe furnizimi, transporti, prerja, lakimi dhe montimi i armaturës së serkllazhit. | m ³ | 2 | 60.0 € | 120.00 € |
| 11 | Furnizimi, transporti, mbushja dhe ngjeshja në shtresa e zhavorit me fraksion (0-32mm) në pjesën e hapësirës për shkallë. | m ³ | 15 | 7.0 € | 105.00 € |
| 12 | Furnizimi, transporti, latimi dhe betonimi i shkalleve me dim.17x30cm me beton të klasës C30/37, në çmim të llogaritet edhe furnizimi, transporti, prerja, lakimi dhe montimi i armaturës rrjetë. | m ³ | 6.5 | 80.0 € | 520.00 € |
| 13 | Furnizimi, transporti, latimi dhe betonimi i shkalleve me dim.17x30cm me beton të klasës C30/37,në pjesën e kah palestra, në çmim të llogaritet edhe furnizimi, transporti, prerja, lakimi dhe montimi i armaturës rrjetë. | m ³ | 3 | 80.0 € | 240.00 € |
| 14 | Demontimi dhe largimi i derës ekzistuese prej hekuri me dim.330x210cm.Largimi të bëhet me kujdes me dëmtime sa më të vogla të, pas demontimit dera të vendoset në vendin e caktuar nga autoriteti kontraktues. | copë | 1 | 50.0 € | 50.00 € |



waterline

Design, Construction,
Plumbing and HVAC Company

SUHAREKË - KOSOVË

| | | | | | |
|----|---|----------------|----|---------|-------------------|
| 15 | Furnizimi, transporti dhe punimi i konstruksionit të mbulesës prej profileve metalike 6x4cm, në çmim të llogaritet saldimi, ljerja me ngjyrë antikorozive dhe me ngjyrë të yndyrshme në dy shtresa, në çmim të llogaritet montimi dhe përforcimi i konstruksionit në serkllazhet prej betoni. | m ² | 26 | 40.0 € | 1,040.00 € |
| 16 | Furnizimi, transporti dhe mbulimi i tunelit me panele Senduiq me trashësi t=5cm, në çmim të llogaritet edhe montimi i panele në konstruksion metalik dhe në serkllazhet e betonit. | m ² | 26 | 30.0 € | 780.00 € |
| 17 | Furnizimi, transporti dhe vendosja e portave të futbollit me dimensione zyrtare të futbollit në përputhje me standardin EN 748. Të prodhuara nga profile alumini të qëndrueshëm, me seksione ovalc 120x100mm. Të përforcuara me lidhje shtesë nëpër këndet e portës. Rrjeta është e varur me sistemin e tensionit të rrjetës me kavo çelik të lakuar në të cilën vendosen kapëset e plastike rezistente në zgjerimin e rrjetës. Dimensione e brendshme 732x244cm. | copë | 2 | 300.0 € | 600.00 € |
| I | Gjithsej punët në ndërtimin e tunelit te fusha e sportit: | | | | 4,904.50 € |

| REKAPITULIMI I PERGJITHSHEM | |
|-----------------------------|--|
| I | PUNIMI I HYRJES PËR ZHVESHTORE NE STADIUM |
| | TOTALI : |
| | 4,904.50 € |

Punëkryesi:

Investitor:
K.K.Rahovec

